


## Morri i kokës (Albanisch)

Morri i kokës është një insekt pa krahë (*Pediculus humanus capitis*), i pajisur me një feçkë thithëse thumbuese dhe tre çifte këmbësh. Nyjet fundore të këmbëve janë të formuara si kthetra në formë grepi. Me këto kthetra morri i kokës mund të mbahet fort mirë për floku, respektivisht të lëviz përgjatë tij. Morrat e kokës ngjiten nëpër flokët, por nuk mund të hidhen, të fluturojnë ose të notojnë. Morrat e rritur kanë një gjatësi afërsisht 2.5 - 3.5 mm. Kafkulla (mburoja) e morrit mund të jetë e tejdukshme, e bardhë në të hirtë ose ngjyrë kafeje. Ngjyra i përshtatet ngjyrës së lëkurës dhe të flokëve. Pas thithjes së gjakut morri duket i kuqërremtë, nga që aparati tretës i mbushur me gjak përmes mbështjellësës vezullon. Morri i kokës shfaqet vetëm në flokët e njerëzve. Vendet e parapëlqyera ndodhen në pjesën e pasme të kokës, në zverk (pjesën e prapme të qafës), prapa veshëve dhe në tëmtha. Morrat e kokës marrin çdo 2 deri në 4 orë gjak të freskët duke e gërvishur shtresën e sipërme të lëkurës dhe nga kjo vrimë e thithin gjakun. Njëkohësisht ata lirojnë një lëng toksik që pengon koagullimin e gjakut dhe shkakton kuarje. Jetëgjatësia e një morri mashkull është afërsisht 15 ditë, femrat jetojnë 30 - 40 ditë. Ata mbijetojnë më së miri në temperaturë 28 - 32°. Një morr pa u ushqyer me gjak mund të mbijetojë më së shumti tri ditë.



Morrat e kokës janë një problem në mbarë botën dhe ndodhin në të gjitha krahinat gjeografike dhe shtresat sociale. Infektimi me morra është rritur në vitet e fundit, ndër të tjera vjen si pasojë përmes mënyrës tonë të jetës: rritja e lëvizjeve, udhëtimet e shumëfishuara dhe migrimi. Prandaj morrat te ne e kanë sezonin e tyre kryesor, më së shumti pas pushimeve verore. 60% nga të gjithë njerëzit e infektuar janë fëmijë të moshës ndërmjet 5 dhe 11 vjeç. Infektimi me morra nuk vjen si pasojë e higjienës së dobët, sepse edhe ata fëmijë të cilët i lajnë flokët e tyre çdo ditë, mund të infektohen nga morrat.

### Cikli i jetës



### Thërijat

Thërijat janë vezë të morrit të kokës. Një morr pjell 3 – 8 vezë në ditë, në total afërsisht 100 – 300 vezë gjatë gjithë jetës së tij, para së gjithash në filluesën e flokut. Thërijat kanë një formë ovale, vezake, janë të mëdha 0.4 – 1 mm. Ata janë të ndritshme, duken ngjajshëm si zbokthi, por që nuk shqiten prej flokut.



### Ngjitja (përçarja)

Ngjitja në rradhë të parë ndodh përmes **kontaktit të drejtpërdrejtë të kokës** nga njeriu në njeri. Por, morrat mund të ngjiten edhe nëpërmjet **kontaktit indirekt** përmes sendeve si krëhërat, furçat, kapelat, helmetat të biçikletave dhe shiritat të ballit. Kafshët shtëpiake nuk janë përçues të morrave.

### Simptomat

- Shpesh kruajre (jo e detyrueshme) përshkak të sekretimeve (pështymës) dhe jashtëqitjeve të morrave. Veçanërisht janë të prekura zonat e zverkut (pjesët e prapme të qafës), pjesa e pasme e kokës dhe prapa veshëve.
- Lëkura e kuqe e ngacmuar në zverkun e qafës (vendi i pickuar) shkakton kuarje të vazhdueshme.
- Rrallëherë edhe ënjtje lokale e nyjave limfatike.

### Mënyra e veprimit për gjetjen e morrave të kokës, vezëve dhe thërijave

1. Kontrolloni fëmijën tuaj në dritë të plotë.
2. Para se të kontrolloni flokët, koka të mos preket dhe të vëzhgoni nëse morrat janë të shikueshme. Morrat struken, sapo të preken flokët.
3. Pas larjes së flokëve i bëni flokët me shumë mirëmbajtës (kondicioner) flokësh. Flokët krehen mirë në mënyrë sistematike, tufë për tufe me një krëhër morrash deri në majat e flokëve.
4. Krëhëri pas çdo tufe fërkohet (fshihet) në një letër të bardhë kuzhine.
5. **Thërijat duhet të hiqen me dorë (në mes të thonjëve), sepse ata ngjiten fortë në flokë. Një lupë (thjerrëz) e ndihmon gjetjen e morrave/thërrijave.**
6. Mirëmbajtësi (kondicioneri) i flokëve duhet të shpëlahet vetëm në fund.
7. Gjithmonë kontrollohet e gjithë koka.

### Skema e krehjes dhe e kurimit

Kur	Çfarë
Dita e 1-rë	<b>A:</b> Nëse ka morra të kokës dhe/ose vezë/thërija ata kurohen me ilaç morrash si dhe të gjitha morrat largohen me krehje dhe thërijat hiqen me dorë. <b>B:</b> Nëse nuk ka as morra të kokës as vezë/thërija nuk është e nevojshme marrja e masave të menjëhershme (megjithatë duhet kontrolluar me krëhër pas 7 ditësh).
Dita e 3-të	<b>A:</b> Largimi me krehje (po qe se akoma ka morra përsëriten kontrollat me krëhër) dhe thërijat hiqen më tej me dorë.
Dita e 7-të	<b>A:</b> Kurimi i dytë i ilaçit të morrave dhe rrjedha sips ditës së parë. <b>B:</b> Kontrollim me krëhër
Dita e 10-të	<b>A+B:</b> Kontrollim me krëhër
Dita e 14-të	<ul style="list-style-type: none"><li>• Nëse edhe mëtej do të gjeni morra të kokës (ose morra të rinj): rifillim i kurimit si në ditën e parë sipas skemës A „kurimi me ilaç morrash dhe largimi me krehje”.</li><li>• Nëse nuk ka as morra të kokës as vezë/thërija, kurimi është i përfunduar.</li></ul>
Dita e 21-të	Për shkak të një ngjitjeje të re të mundshme, gjatë 2 javëve të ardhshme do të duhet të kryhet një kontrollim me krëhër (1herë në javë).
Dita e 28-të	Për shkak të një ngjitjeje të re të mundshme, gjatë 2 javëve të ardhshme do të duhet të kryhet një kontrollim me krëhër (1herë në javë).

**Nëse fëmija edhe në kontrollat e mëpasme ka akoma morra dhe thërija, përgjegjësja për morra në marrëveshje me mjekun e shkollës mund të rekomandojë çlirim nga mësimi. Çlirimet e ndjekjes së shkollës zgjasin aq gjatë, derisa fëmija nuk do të ketë më morra dhe thërija.**

### Me rëndësi

- Gjatë infektimit me morra, për të penguar përhapjen e mëtejshme, patjetër shpejt informoni rrethin e afërm: shkollën, shkollën ditore, miqtë, etj.
- Bleni ilaç morrash në farmaci ose në drogeri (si p.sh. Rausch, Laus-Stop, Lies-Ex, Hedrin, Pedicul, Her-mal). Produktin përdorni saktësisht sipas udhëzimit. Produktet kimike përmbajnë insekticide dhe mund të jenë të dëmshme. Më tej mund të zhvillohet një rezistencë, që do të thotë se morrat nuk do të ngordhin.
- 1x në javë të gjithë anëtarët e familjes, përfshirë edhe fëmijët me përkujdesje ditore, të kontrollohen për morra edhe thërija.
- Krëhërat, furçat dhe të gjitha mjetet e flokëve në kohëzgjatje prej 15 min. vëndohen në ujë të nxehtë me sapun dhe lahen.
- Gjërat që lahen, të cilat kishin kontakt të drejtpërdrejt me flokët e infektuara, të lahen në 40 - 60° ose 7 ditë të mos përdoren dhe të ruhen në një qese plastike të mbyllur mirë (para së gjithash kafshët prej stofi dhe jastëkët).
- Teshat, shiltet (shtresat e buta) dhe çarçafët e shtratit të lahen edhe në ditën e parë të kurimit edhe pas 7 ditësh. Mbase edhe një herë pas 14 ditësh.
- Flokët e gjata të lidhen, për arsye që të zvoglohet kontakti i drejtpërdrejtë i flokëve.
- Helmetat e biçikletave, mbulesat e kokës, stolitë dhe furçat e flokëve të mos shkëmbehen mes njëri-tjetrit.